



23.8.2021

Informacion për prindërit

fëmijët e të cilëve marrin përkujdesje në qendrat e kujdesit ditor ose çerdhe

Informacion për operatorët, drejtuesit, personelin

e qendrave të kujdesit ditor dhe çerdhet

Rregullore të reja në kujdesin ditor përmes rregullores së ndryshuar për koronavirusin

Nga sot, e hënë, në kujdesin ditor për fëmijë zbatohen rregullorja e ndryshuar e kujdesit për koronavirusin (Corona- BetrVO). Në një vijë me sektorët e tjerë shoqërorë, rregulli 3G zbatohet për hyrjen në ambientet e kujdesit ditor dhe në ambiente të mbyllura është e detyrueshme mbajtja e maskës. Ka përjashtime në të dy rastet.

Rregullat vlejnë për punonjësit, personelin e qendrave të kujdesit ditor dhe prindërit, si dhe personat e tjerë (të tretë). Ato **nuk** zbatohen për fëmijët deri në hyrjen në shkollë. Por ato zbatohen dhe për fëmijët e moshës shkollore.

Janë bërë ndryshimet e mëposhtme në sektorin e kujdesit ditor për fëmijë:

Mbajtja e detyrueshme e maskave në ambiente të mbyllura

Në ambiente të mbyllura duhet të mbahet të paktën një maskë mjekësore nga të gjithë

personat (punonjësit, personeli i kujdesit ditor, prindërit dhe të tretët) pavarësisht respektimit të distancës minimale.

Nga kjo përjashtohen:

- punonjësit dhe personeli i kujdesit ditor gjatë kujdesit kundrejt fëmijëve pa persona të tjerë të pranishëm
- punonjësit dhe personeli i kujdesit ditor vetëm nëse takohen punonjësit ose personeli ditor i imunizuar (sapo të jenë të pranishëm personat e testuar, zbatohet mbajtje e detyrueshme e maskave për të gjithë)
- të gjithë personat, nëse ofruesi i kujdesit e gjykon të nevojshme për heqjen e përkohshme të markave për nevoja arsimore edhe në praninë e prindërve apo të të tretëve. Në këto raste duhet respektuar distanca minimale mes të rriturve.
- Prindërit dhe punonjësit, nëse janë në ndenjese fikse ose poste qëndrimi në këmbë brenda kuadrit të komisioneve të pjesëmarrjes së prindërve
- të gjithë personat që nuk mund të mbajnë maskë për arsye të provuara mjekësore
- Të gjithë personat që komunikojnë me persona të shurdhër apo me vështirësi dëgjimi
- veçanërisht për të gjithë personat në disa situata të tjera të përshkruara më në detaj në § 4, paragrafi 2 i rregullores për kujdesin ndaj koronavirusit p.sh. me ofrim vaktesh dhe ushtrimesh ose muzike

Në përditshmërinë e kujdesit ditor ka ndërkaq kërkesë për mbajtjen e rregullt të maskës për të gjithë pjesëmarrësit në kontakt me punonjësit, personelin e kujdesit ditor, prindërit ose palë të treta. Në rastin e kujdesit me fëmijë pa persona të tjerë të pranishëm, nuk ka nevojë për maska.

Rregulli 3G për aksesin

Brenda kuptimit të rregullit 3G (akses vetëm për të vaksinuarit, të shëruarit apo të testuarit) vetëm personat e imunizuar ose të testuar (punonjës, prindër dhe palë të treta) kanë akses në ofertat e kujdesit ditor.

Zbatohen përjashtime:

- për prindërit kur sjellin dhe marrin fëmijët
- për fëmijët e moshës shkollore dhe adoleshentët që janë të barabartë me të

testuarit nëpërmjet testimit të rregullt në shkollë

- në raste emergjencash

Personave të paimunizuar apo të patestuar nuk u lejohet të hyjnë në ofertën e kujdesit ditor jashtë situatës së sjelljes dhe marrjes së fëmijëve. Drejtuesit e qendrave të kujdesit ditor kanë për detyrë të përjashtojnë personat përkatës nga pjesëmarrja në oferta.

Pajtimi me detyrimin e testimit

Për punonjësit, detyrimi i testimit konsiderohet i përmbushur nëse marrin pjesë në testimet për qytetarët po në testin e mbikëqyrur nga punëdhënësi, dy herë në javë kalendarike.

Testi i mbikëqyrur nga punëdhënësi është një rapid-test i ofruar pa pagesë nga punëdhënësi, i cili kryhet nga personel i kualifikuar ose i trajnuar, ose kryhet nën mbikëqyrjen e një personi të kualifikuar dhe të trajnuar po të udhëzuar.

Duke qenë se testi i mbikëqyrur për punonjësit nuk është e mundur të kryhet për të vetëpunësuarit e kujdesit ditor, detyrimi i testimit konsiderohet i përmbushur vetëm nëse testohen dy herë në javë si pjesë e testit për qytetarët.

Prindërit dhe të tretët duhet të paraqesin testin për qytetarët të jo më të gjatë se të 48 orëve më parë për të përmbushur detyrimin e testimit.

**Ministria për Fëmijët, Familjen, Refugjatët dhe Integrimin e Landit të Rinit
Verior-Vestfalisë**